

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: QENDRA KLIN.STOMATOLOGJIKE

Për Aktivitetin e Prokurimit: 220/70900-26-5159-1-3-6

Sa i përket tenderit për Furnizim me Unit portabël

ANKESË

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

"Pro Medical"

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Kadri Zeka

(Adresa)

Ferizaj

(Vendi)

70000

(Kodi postar)

049-631-245

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Adnan Bala

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

promedical.fr@gmail.com

(Adresa elektronike)



27.07.2026

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)



2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi per kontrate: 26.06.2026

Letrat standarde 15.07.2026 pra Vendimi AK

Kerkesa per Refuzim me date 17.07.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☐

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Dispozitat e shkelura të LPP-së:

Neni 1 – Qëllimi

Neni 7 – Barazia në trajtim / jo diskriminimi

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Neni 1- Qëllimi -E kundërshtojmë vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 15.07.2026 ngase i njëjti është në kundërshtim me nenin 1 të Ligjit për Prokurim Publik dhe paragrafin nuk ka marrë në konsideratë detyrimin.

AK në këtë rastin tonë ka shkelur Nenin 1 paragrafin 2 të LPP citim “Ky ligj gjithashtu ka për qëllim të sigurojë integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lartë të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”

Neni 59 – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve - Lidhur me shkeljen e Nenit 59 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve, AK gjatë procesit të ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve, nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat e Nenit 59 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), pasi ka ndërmarrë një vlerësim që është në kundërshtim me kërkesat e LPP-së dhe me kriteret e përcaktuara në Dosjen e Tenderit.

Konkretisht, oferta jonë është eliminuar me arsyetimin si më poshtë:

Ne Specifikat teknike të Unitit dentar portable është kërkuar:

- Është kërkuar- Zhurma e Operimit ~ 40 dB (A).

Ndërsa në katalogun e ofertës tuaj është ofruar: 48 dB.

Duke ju referuar ndryshimeve me lartë komisioni vlerësues ka konstatuar se oferta e dorëzuar nga OE Nuk është në pajtim me specifikat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit.

Pra AK, nuk ka vepruar në përputhje me nenin 59 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), pasi oferta jonë është vlerësuar në mënyrë të gabuar, duke u mbështetur në një interpretim arbitrar të specifikimeve teknike dhe jo në kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit.

Në njoftimin për eliminim, AK ka konstatuar se oferta jonë është e papërgjegjshme me arsyetimin se pajisja e ofertuar ka nivel zhurme 48 dB(A), ndërsa në Dosjen e Tenderit është kërkuar:

- Zhurma e Operimit ~ 40 dB (A).

"Zhurma e Operimit ~40 dB(A)" Ky arsyetim nuk gjen mbështetje as në Dosjen e Tenderit dhe as në nenin 59 të LPP-së, pasi nuk bazohet në një vlerësim objektiv, të paanshëm dhe profesional të dokumentacionit teknik të dorëzuar. Në radhë të parë, simboli "~" pra "~" në anglisht **tilde** ka kuptim teknik dhe universal **"afërsisht"**, **"rreth"** (approximately). Prandaj, formulimi **"~40 dB(A)"** përfaqëson një vlerë orientuese dhe jo një kufi maksimal të detyrueshëm.

AK ka interpretuar gabimisht specifikimin teknik, pasi simboli "~" ka një kuptim të njohur teknik dhe ndërkombëtar, që nënkupton "afërsisht" (approximately) ose "rreth", duke lejuar një tolerancë të arsyeshme nga vlera e referuar. Mungesa e njohurive teknike ose interpretimi i gabuar i këtij simboli nga ana e AK-së nuk mund të përdoret si bazë për penalizimin apo eliminimin e OE-së. Në rastin konkret, oferta e OE-së është në përputhje me kuptimin teknik të specifikimit dhe nuk ekziston asnjë bazë e arsyeshme për ta konsideruar atë si jokonformuese.

Nëse qëllimi i AK do të kishte qenë vendosja e një kufiri maksimal të detyrueshëm, atëherë kjo duhej të ishte përcaktuar qartë në Dosjen e Tenderit me formulime të tilla si:

maksimumi 40 dB(A);

≤40 dB(A); ose

jo më shumë se 40 dB(A).

Asnjë formulim i tillë nuk ekziston në Dosjen e Tenderit. Për rrjedhojë, gjatë fazës së vlerësimit AK nuk ka të drejtë të ndryshojë përmbajtjen e specifikimeve teknike duke i interpretuar ato sikur të përmbanin një kufi maksimal që nuk është përcaktuar në DT. Një veprim i tillë është në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së, sipas të cilit ofertat duhet të vlerësohen vetëm mbi bazën e kriterëve dhe kërkesave të përcaktuara paraprakisht në Dosjen e Tenderit.

Po ashtu, AK dhe Njësia Kërkuese kanë pasur detyrim që specifikimet teknike t'i interpretojnë në përputhje me qëllimin e tyre dhe me karakteristikat reale të produktit të ofertuar, duke u bazuar në dokumentacionin teknik të dorëzuar nga operatori ekonomik dhe jo në interpretime restriktive që nuk mbështeten në dokumentacionin e tenderit.

Vlerësimi i përputhshmërisë së ofertës nuk mund të mbështetet në supozime ose interpretime subjektive, por duhet të bazohet në kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit.

Për më tepër, diferenca ndërmjet vlerës **~40 dB(A)** dhe 48 dB(A) nuk mund të konsiderohet automatikisht si mospërmbushje e specifikimit teknik, pasi vetë AK nuk ka përcaktuar asnjë tolerancë dhe asnjë kufi maksimal të lejuar.

Gjithashtu, pajisja e ofertuar është e certifikuar për tregun e Bashkimit Evropian dhe është në përputhje me standardin EU Directive 93/42/EEC.

Përkundrazi, gjatë fazës së vlerësimit, Autoriteti Kontraktues ka shtuar një kriter të ri teknik **"maksimumi 40 dB(A)"** – i cili nuk ekziston në Dosjen e Tenderit. Një veprim i tillë përbën ndryshim të kërkesave teknike pas hapjes së ofertave dhe është në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së, si dhe me parimet themelore të transparencës, trajtimit të barabartë, proporcionalitetit dhe konkurrencës së drejtë.

Si rrjedhojë, elimini i ofertës së Pro Medical SH.P.K. nuk mbështetet në kërkesat e DT, përfshirë Aneksin 1 – Specifikimet Teknike të Detyrueshme, dhe as në dispozitat e nenit 59 të Ligjit për Prokurimin Publik. Përkundrazi, ai është rezultat i një interpretimi të gabuar, arbitrar dhe restriktiv të specifikimeve teknike nga Autoriteti Kontraktues, i cili gjatë fazës së vlerësimit i ka dhënë kërkesës teknike një kuptim që nuk është përcaktuar në dokumentacionin e tenderit.

Për këto arsye, kërkojmë që Kërkesa për Rishqyrtim të aprovohet si e bazuar, të anulohet vendimi për eliminimin e ofertës sonë dhe lënda të kthehet në rivlerësim, me obligimin që Autoriteti Kontraktues të kryejë një vlerësim objektiv, të paanshëm dhe në përputhje me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik, duke u bazuar vetëm në kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit, ndërsa oferta e Pro Medical SH.P.K. të rivlerësohet në përputhje me kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe dispozitat e LPP.

Sepse ne vlerësojmë se ky arsyetim i AK nuk mbështetet në kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe as në dispozitat e Nenit 59 të LPP-së, pasi AK nuk ka bërë një vlerësim objektiv, të paanshëm dhe të bazuar në DT e dorëzuar me ofertën tonë.

Po ashtu, Autoriteti Kontraktues dhe Njësia Kërkuese duhet të kenë parasysh se specifikimet teknike duhet të interpretohen në përputhje me qëllimin e tyre dhe me karakteristikat reale të produktit të ofertuar, duke u bazuar sipas psecikave të DT.

Gjithashtu, AK ka cituar në DT se: "Në bazë të specifikimeve të paraqitura më sipër, komisioni kërkon

furnizim me një pajisje që përputhet me përshkrimin e dhënë. Në rast se një pajisje identike nuk është e disponueshme në treg, lejohet furnizimi me një pajisje ekuivalente, e cila ofron të njëjtat karakteristika teknike, funksionalitet dhe performancë si pajisja e përshkruar në këtë dokument"

Ky formulim i Dosjes së Tenderit konfirmon se vetë AK ka lejuar ofertimin e pajisjeve **ekuivalente**, duke pranuar se pajisja e kërkuar nuk duhet domosdoshmërisht të jetë identike në çdo karakteristikë teknike, për sa kohë që ofron funksionalitetin, performancën dhe karakteristikat thelbësore të kërkuara.

Prandaj, gjatë fazës së vlerësimit, AK ka pasur detyrim të vlerësojë nëse pajisja e ofertuar nga **Pro Medical SH.P.K.** është funksionalisht dhe teknikisht ekuivalente me kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe jo të eliminojë ofertën mbi bazën e një dallimi të izoluar, i cili nuk është përcaktuar si kriter absolut apo kufi maksimal në dokumentacionin e tenderit.

Përkundrazi, eliminimi është mbështetur vetëm në një interpretim të gabuar të formulimit "**~40 dB(A)**", duke e trajtuar atë si një kufi maksimal të detyrueshëm, ndonëse një kufizim i tillë nuk është përcaktuar në Dosjen e Tenderit(DT).

Për më tepër, duke qenë se vetë DT lejon ofertimin e pajisjeve ekuivalente, AK nuk mund të kërkojë gjatë fazës së vlerësimit përputhje absolute me çdo parametër teknik, kur një kërkesë e tillë nuk është shprehur qartë në dokumentacionin e tenderit. Një interpretim i tillë bie ndesh me nenin 59 të Ligjit për Prokurimin Publik, pasi ndryshon përmbajtjen e specifikimeve teknike pas publikimit të tenderit dhe cenon parimet e transparencës, trajtimit të barabartë dhe konkurrencës së drejtë.

Për këto arsye, eliminimi i ofertës sonë mbi këtë bazë është i papabazuar në aspektin teknik dhe juridik dhe, si i tillë, duhet të anulohet.

Pika 2 e Ankesës

Pas kemi pranuar dokumentet e OE së së rekomanduar, kemi konstatuar se AK ka vepruar në kundërshtim me **Nenin 7 - Barazia në Trajtim / Mosdiskriminimi** dhe **Nenin 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve**, për arsyet si në vijim:

OE i rekomanduar nuk ka dorëzuar katalogun e prodhuesit, ndonëse kjo ka qenë një kërkesë e qartë e Dosjes së Tenderit, përkatësisht:

Kërkesa 3: "Deklarata për specifikacionin teknik për mallrat e ofruara dhe katalogu i prodhuesit."

Pra pra nuk ka as model dhe as prodhues në katalogu paisjes, përkundër mosplotësimit të kësaj kërkesë, AK e ka konsideruar ofertën e OE-së si të përgjegjshme dhe e ka rekomanduar për dhënie të kontratës, duke vepruar në kundërshtim me kushtet e përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe me parimet e trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë.

Në paramasën (ofertën) teknike, OE i rekomanduar ka deklaruar si prodhues **Wellstar Medical**, siç dëshmohet nga dokumentacioni i dorëzuar. Megjithatë, certifikata e paraqitur nuk është lëshuar për këtë prodhues, por për një prodhues tjetër.

Titulli prodhues	Shënim operatori ekonomik	Shënim autoriteti kontraktues	Vendi i origjinës
20 Wellstar medical	Mtkos pharm shpk		Kina

Kurse në Udhezuesin për PP pra Pika 10.1

Formulari i tenderit nuk është plotësuar si duhet apo mungon	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	Kusht administrativ
--	---	---------------------

Nga dokumentacioni i dorëzuar rezulton se në **Formularin e Tenderit** OE ka deklaruar si prodhues **Wellstar Medical**, ndërsa në certifikatën e paraqitur figuron:

Manufacturer's Name: GUANGZHOU BEST DENT MEDICAL EQUIPMENT CO., LTD.

ATTESTATION OF CONFORMITY

Verification Number : TD38042401

Applicant's Name : GUANGZHOU BEST DENT MEDICAL EQUIPMENT CO., LTD

Applicant's Address : NO. 301 A BUILDING, NO.2 ANPING ROAD, HUIJIANG VILLAGE, DASHI STREET, PANYU DISTRICT, GUANGZHOU CITY, GUANGDONG PROVINCE CHINA

Manufacturer's Name : GUANGZHOU BEST DENT MEDICAL EQUIPMENT CO., LTD

Ky mospërputhje dëshmon se informacioni i deklaruar në Formularin e Tenderit nuk

përputhet me dokumentacionin mbështetës të dorëzuar nga vetë OE.

Për rrjedhojë, OE nuk ka plotësuar Formularin e Tenderit në përputhje me kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik. AK ka qenë e obliguar, në përputhje me **Nenin 59 të LPP-së**, të verifikojë përputhshmërinë e deklarimeve të OE-së me dokumentacionin mbështetës. Pranimi i një oferte që përmban mospërputhje ndërmjet prodhuesit të deklaruar dhe prodhuesit të evidentuar në certifikatë cenon parimin e trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë, të paraparë me **Nenin 7 të LPP-së**, pasi operatorët ekonomikë duhet të vlerësohen mbi bazën e të njëjtave kritere dhe të dokumentacionit të saktë, të plotë dhe konsistent. Prandaj, oferta e OE-së së rekomanduar nuk është në përputhje me kërkesat e Dosjes së Tenderit.

VENDIMI

Aprovohet Kërkesa për Rishqyrtim si e bazuar e OE " Pro Medical"

Dhe lenda të Ri-kethen ne ri-vlersim.

Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Shkeljet e AK na kanë shkaktuar dëme materiale të konsiderueshme dhe të drejtpërdrejta. Kompania jonë ka investuar kohë, burime financiare dhe njerëzore në përgatitjen e kësaj oferte, përfshirë përkthimin, përgatitjen e katalogëve të personalizuar, mbledhjen e certifikatave dhe dokumenteve të tjera teknike dhe administrative.

9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

a) Te gjitha dokumentet relevante jane ne e-prokurimi